

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MSC CERTIFICATIONS” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR
“MSC CERTIFICATIONS” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“MSC CERTIFICATIONS” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“MSC CERTIFICATIONS”**, zoterohet nga ortaku:

1. Z. Eneriko Hajdaraj me atësi Selfo i datëlindjes 04/05/1991, lindur në Berat dhe banues në Rruga Artan Lenja , Kompleksi Kontakt, Ap 1602, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartes se identitetit me nr 037884651, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “**MSC CERTIFICATIONS**” **Sh.p.k.** mbi bazën e këtyre principeve:

NENI 1 FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakeve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë “**MSC CERTIFICATIONS**” **Sh.p.k.**

NENI 2 BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3 SELIA

Selia e shoqërisë është në adresën: TIRANË Rruga "Ismail Qemali", Pallati 34/1, Apartamenti 3, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblese, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4 KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria " **MSC CERTIFICATIONS** " sh.p.k është e organizuar në formën e një shoqërie që merret me:

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar,

brenda ose jashteterritorit të Republikës së Shqipërisë. Çertifikimi ISO I sistemeve të menaxhimit të cilësive, sistemeve të menaxhimit të mjedisit, sistemeve të menaxhimit të energjitikës, sistemeve të menaxhimit të sigurisë dhe Shendetit në vendin e punës, sistemeve të menaxhimit të sigurisë dhe informacionit, sistemet e menaxhimit kundër rryshfetit, sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore dhe H.A.C.C.P, çdo veprimtari tjetër çertifikimi me qëllim vertetimin e konformitetit të parashikuara nga dispozitat e legjislativitetit vendas, rregullat ndërkombëtare, si dhe në direktivat e bashkimit evropian; vendosja e markave CE të gjitha produkteve. Lëshimin e raporteve dhe/ose çertifikatave që vertetojnë këto përputhshmëri; zhvillim praktikash biznesi; Veprimtari inspektimi, analize; veprimtarinë e kerkimit dhe provës mbi materiale, produkte dhe procese teknologjike, duke promovuar përhapjen, përdorimin dhe përfshirjen e rregullave teknike si dhe të teknologjive, proceseve, materialeve dhe metodologjive të menaxhimit inovativ; ofrimin e shërbimeve të formimit dhe trajnues. Shërbime ndërmjetësi tregtar. Ofrimi i shërbimeve të analizës GAP kundërsht të gjitha sistemeve të menaxhimit, proceseve, normave të referimit, skemave private, standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkesave ligjore të parashikuara nga legjislativiteti kombëtar, kërkesave rregullatore Evropiane dhe ndërkombëtare. Auditim, çertifikimi dhe ofrimi i shërbimeve të GAP Analizës në lidhje me standardet ndërkombëtare ISO, sistemet e menaxhimit sipas skemave të ndryshme private, kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfshirë por pa u kufizuar në normat e referencës BRC, IFS, FSSC 22000, GLOBAL G.A.P. ; çdo aktivitet të ngjashëm me si më sipër.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke (njëqindmijë Leke), i ndarë në 1 (një) pjesë. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

- Z. Eneriko Hajdaraj një quote të barabartë me 100 % - 100.000 Lekë (njëqindmijë).

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyet tërësisht dhe depozitohet në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç ketij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk është ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “MSC CERTIFICATIONS” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, është emëruar:

Eneriko Hajdaraj, te ciles i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe e identifikuar me karte identiteti me nr 034250519.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

Tirane, 01/03/2024

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

“MSC CERTIFICATIONS” Sh.p.k.

Eneriko Hajdaraj

